



**VENDIM**

*Nr. 31 Datë 26.03.2012*

**PËR**

**FILLIMIN E PROCEDURAVE PËR LIÇENSIMIN E SHOQËRISË  
“ALBPETROL” SH.A NË AKTIVITETIN E SHPËRNDARJES SË  
GAZIT NATYROR**

Në mbështetje të Ligjit Nr. 9946, date 30.06.2008 “Për Sektorin e Gazit Natyror”, neni 14, pika 1, germa “b”, si dhe të “Rregullave dhe Procedurave për Liçensimin, Ndryshimin, Transferimin e Pjesshëm ose të Plotë, Heqjen dhe Rinovimin e Liçensave në sektorin e Gazit Natyror.” neni 4, pika 1, germa “b”; neni 8, neni 9 pika 1, germa “a”, “b”, “c”, “d”; pika 2, germa “b” dhe neni 10, miratuar me Vendimin e Bordit të Komisionerëve nr. 09, datë 11.02.2011, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (E.R.E), në mbledhjen e tij të datës 26.03.2012, mbasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria “ALBPETROL sha”, si dhe relacionin e Drejtorisë së Liçensimit dhe Monitorimit të Tregut dhe Drejtorisë Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit për liçensimin në aktivitetin e shpërndarjes të gazit natyror të kësaj shoqërie,

**Konstatohet se:**

Aplikimi i shoqërisë “ALBPETROL sha”, plotëson pjesërisht kërkesat për liçensimin në aktivitetin e shpërndarjes së gazit natyror të kësaj shoqërie, të parashikuara nga ERE në Rregulloren për procedurat e liçensimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të liçensave,

Për gjithë sa më sipër Bordi i Komisionerëve të ERE-s,

**Vendos:**

1. Të fillojë procedurat për shqyrtimin e aplikimit të shoqërisë “ALBPETROL sha” në aktivitetin e shpërndarjes të gazit natyror
2. Ngarkohet Drejtorja e Liçensimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.